



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



| | | | |
|------------------------------------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|--------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Priljena / Predato Received / Delivered | 25.09.2023 | 3 | viti god year |
| Organ / Njësia Organ / Jedinstva Org / Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicitna Quantity |
| SKIMBETEK | 6240/2023 | | 1/4 |



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1094/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Eshref Shabani, anëtarë me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1094/2023 të datës 21.08.2023 të parashtruar nga ankuesja

në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.09.2023, mori këtë.

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1094/2023 e datës 21.08.2023, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli RAN0015826/02 i datës 19.07.2023 i Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prezentit.

Arsyetim

(tani e tutje referuar si ankuesja), e cila sipas shkresave të lëndës është kandidate në procedurën e rekrutimit për grupin Specialistë i Teknologjisë Informative, gjegjësisht për pozitën "Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative" në Komunën e Prizrenit, me datë 21.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5725 të regjistruar nën shenjen A.nr.1094/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër RAN0015826/02 të datës 19.07.2023 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prezentit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullore Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 24.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese të Komuna e Prizrenit, ndërsa me datë 31.08.2023, nga kjo e fundit ka pranuar përgjigjen në ankese se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr. 1094/2023 të datës 21.08.2023; Konkursin e datës 07.06.2023; Vendimin me numër protokolli RAN0015826/02 të datës 19.07.2023 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit; Njoftimin e datës 19.07.2023; Kontrata e punës të datës 21.02.2022; Kontratën e punës të datës 21.03.2022; Vërtetimin e datës 30.05.2023; Vendimin Nr.RN00011835/01 të datës 20.07.2023, për Themelimin e Komisionit për Zhvillimin e Procedurës së Rekrutimit; Njoftimin e datës 12.07.2023; Vendimin RAN 0015826/01 të datës 11.07.2023; Ankesën e datës 13.07.2023, drejtuar Komunës së Prizrenit; Vendimin RAN0015826/02 të datës 19.07.2023; Aplikacionin e ankueses, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë Nr.6 të datës 09.10.2017; Diplomë Nr.29 të datës 15.01.2015; Certifikatën e datës 18.05.2022; Certifikatën e datës 27-29, të vitit 2019; Vërtetimin me numër protokolli 348/2023 të datës 30.05.2023, për përvojën e punës; Përgjigjen në ankese me numër protokolli 1094/2023 të datës 31.08.2023, si dhe shkresa tjera relevante për rastin konkret.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses

është e pa bazuar sepse:

Kolegji i Këshillit nga provat e administruara të lëndës ka gjetur se Komuna e Prizrenit me datë 07.06.2023 (afati për aplikim 28.06.2023 - 05.07.2023) ka shpallur konkursin e jashtëm për pranim për grupin *Specialistë i Teknologjisë Informative, respektivisht pozitën "Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative"* me numër të referencës RN00011835. Rrjedhimisht, sipas Vendimit RAN0015826/01 të datës 11.07.2023, rezulton se ankuesja nuk është përfshirë në listën e ngushtë për të vazhduar në fazën tjetër të procedurës për pozitën përkatëse të punës, me arsyetimin se e njëjta me rastin e aplikimit nuk ka bashkangjitur edhe pasqyrën nga Trusti Pensional i Kosovës lidhur me përvojën e punës në sektorin privat.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin RAN0015826/01, me datë 13.07.2023 ka parashtruar ankesë pranë Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit, ndërsa kjo e fundit me Vendimin me numër RAN0015826/02 të datës 17.07.2023 ka refuzuar si të pa bazuar ankesën me arsyetimin se pala ankuese me rastin e aplikimit ashtu sikurse edhe me rastin e shqyrtimit të ankesës nuk ka arritur të dëshmojë përvojën e punës në sektorin privat edhe me dokumente përcjellëse nga Trusti Pensional i Kosovës, edhe përkundër faktit se të njëjtës i janë kërkuar dokumentet përkatëse gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Kolegji i Këshillit në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore fillimisht analizoj Konkursin për pranim për grupin *Specialistë i Teknologjisë Informative, respektivisht pozitën "Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative"* me numër të referencës RN00011835 dhe për pasojë konstatoi se kriteret formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë:

- Arsimi i kërkuar: *Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Diplomë e nivelit të pestë të Kornizave Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) për profesion deficitarë (TIK); Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakulteti i Elektroteknikës;*
- Kualifikime të posaçme formale: *Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase;*
- Përvoja e punës e kërkuar: *Se paku (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës;*

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesja lidhur me plotësimin e kriterit të kualifikimit, me rastin e aplikimit ka dorëzuar Diplomën me numër 29 të datës



15.01.2015 me të cilën vërtetohet se e njëjta ka përfunduar studimet themelore-bachelor me datë 10.10.2013 në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike - Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren, si dhe Diplomën me numër 06 të datës 09.10.2017 me të cilën vërtetohet se e njëjta ka përfunduar studimet postdiplomike/master në Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, po ashtu në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, nga rrjedh se e njëjta ka plotësuar kriterin e vendosur në aspektin e kualifikimit. Ndërsa, sa i përket kriterit të përvojës së punës e njëjta ka dorëzuar Kontratën me numër reference 097/2022 të datës 21.02.2023 ku theksohet se ankuesja ka qenë e punësuar me kohë të caktuar (01.03.2022-30.09.2023) si Ligjëruese në Kolegjin "AAB", si dhe Kontratën me numër reference 164/2023 të datës 21.03.2023 ku theksohet se ankuesja ka qenë e punësuar me kohë të caktuar (01.03.2023-30.06.2023) si Zyrtare për Sigurimin e Cilësisë në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike pranë Kolegjit "AAB". Po ashtu e njëjta ka dorëzuar Vërtetimin me numër protokoll 348/2023 të datës 30.05.2023 të lëshuar nga Kolegji "Pjetër Budi" ku specifikohet se ankuesja është në marrëdhënie të punës në cilësinë e mësimdhënëses për lëndët që i përgjigjen thirrjes së saj akademike, në Kolegjin "Pjetër Budi" në Prishtinë, nga data 01.11.2017, përkatësisht nga viti akademik 2017/2018, 2018/2019, 2019/2020, 2020/2021, 2021/2022 dhe vazhdon 2022/2023.

Nga analizimi i shkresave të lëndës, të dorëzuara nga palët në procedurë, rezulton se ankuesja përvojën e punës në institucione private, gjegjësisht në Kolegjin "AAB" dhe Kolegjin "Pjetër Budi" nuk e ka dëshmuar edhe me dokumente përcjellëse nga Trusti i Pensional i Kosovës. Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, përvoja e punës në sektorin privat e provuar vetëm përmes shkresave të lëshuar nga punëdhënësi nuk është dëshmi e mjaftueshme dhe e vlefshme nëse të njëjtat nuk janë të shoqëruara edhe me vërtetim nga organet kompetente, gjegjësisht Administrata Tatimore apo Trusti Pensional, standard ky tani me i vendosur edhe nga Gjykata e Apelit e Kosovës, ku si rrjedhojë me Aktvendimin me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës theksohet fakti se dëshmitë e përvojës së punës në sektorin privat duhet të mbështeten edhe me vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës apo dëshmi të lëshuar nga Trusti Pensional i Kosovës.

Për sa me sipër dhe duke qenë se nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se ankuesja me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës, lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së punës, përveç Kontratës me numër reference 097/2022 të datës 21.02.2023, Kontratës me numër reference 164/2023 të datës 21.03.2023 të lëshuara nga Kolegji "AAB", si dhe Vërtetimit me numër protokoll 348/2023 të datës 30.05.2023 të lëshuar nga Kolegji "Pjetër Budi" nuk ka sjell edhe dëshmi mbështetëse nga Administrata Tatimore e Kosovës me të cilën do të vërtetohej se punëdhënësi privat ka paguar detyrime tatimore ne raport me ankuesen apo dëshmi nga Trusti Pensional i Kosovës ku do të vërtetohej se e njëjta ka paguar kontribute pensionale për aq kohe sa ka punuar te punëdhënësi privat, Kolegji i Këshillit vlerëson se Njësia e Burimeve Njerëzore si njësi përgjegjëse pranë Komunës së Prizrenit ka zbatuar drejt ligjin material me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër RAN0015826/01 të datës 11.07.2023 për refuzimin e aplikacionit të ankueses, duke vepruar kështu në pajtim me nenin 15 paragrafët 1, 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet së: *1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim.2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë, dhe po ashtu, i njëjti organ ka zbatuar drejt ligjin material*

dhe ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike me rastin e refuzimit të ankesës së ankueses me Vendimin me numër RAN0015826/01 të datës 17.07.2023, ngase edhe përkundër faktit se ankuesja e konfirmon se organi punëdhënës i ka dhënë mundësin që t'i dorëzojë dokumentet përkatëse gjatë fazës së shqyrtimit të ankesës, e njëjta ka dështuar që t'i sjell dokumentet e kërkuara, gjegjësisht vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës apo pasqyrën e Trusti Pensional të Kosovës, për të vërtetuar përvojën e punës në Kolegjin "AAB" dhe Kolegjin "Pjetër Budi" si bartëses privat të arsimit të lartë në Kosovë.

Andaj, pretendimi ankimor i ankueses se e njëjta ka plotësuar kriterin e përvojës së punës është i paqëndrueshëm, ngase me dispozitat e Ligjit Nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, respektivisht nenit 6 paragrafi 6.1 përcaktohet se: *6.1 Çdo punëdhënës është i obliguar që të kontribuojë në emër të punonjësve të vet në Fondin e kursimeve pensionale. Punonjësit obligohen që të kontribuojnë në emër të vet në kursimet pensionale. Obligimet e punëdhënësit dhe të punonjësit fillojnë në ditën e parë të punësimit të punëdhënësit për punonjësit që kanë krijuar marrëdhënie pune dhe përfundojnë kur punonjësi arrin moshën e pensionit*, ndërsa me Aktvendimin AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, theksohet se dëshmitë e përvojës së punës duhet të dëshmojnë me kontratë pune dhe me vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës apo dëshmi të lëshuar nga Trusti Pensional i Kosovës, detyrim ky ligjor i përcaktuar edhe me nenin 9 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, kështu që Kolegji i Këshillit konstaton se Kontrata me numër reference 097/2022 e datës 21.02.2023, Kontrata me numër reference 164/2023 e datës 21.03.2023 të lëshuara nga Kolegji "AAB", si dhe Vërtetimi me numër protokolli 348/2023 i datës 30.05.2023 i lëshuar nga Kolegji "Pjetër Budi" nuk janë dokumente të mjaftueshëm për vërtetimin e përvojës së punës të kërkuar si në konkurs, dhe se me të drejtë është refuzuar aplikacioni dhe pastaj edhe ankesa nga ana e njësisë përgjegjëse, gjegjësisht Njësia për Burime Njerëzore e Komunës së Prizrenit.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1094/2023

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Jeton Koca

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.